REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OFLIPJAN

**Departamenti i Prokurimit** **Data: 28.03.2025**

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2 ) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për Ri-Shqyrtim** të datës; 26.03.2025, të parashtruar nga OE SHPK PM GROUP, Rr Anton Çettanr 3, Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim me material hixhenik për IEA-të dhe institucionet komunale" me nr. të Prokurimit, 613-25-376-1-2-1, Autoriteti kontraktues nxjerr:

## V E N D I M

**I Refuzohet,** kërkesa për ri-shqyrtim, **kërkesë e paraqitur më dt; 26.03.2025 nga** OE SHPK PM GROUP, Rr Anton Çettanr 3, Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:
"Furnizim me material hixhenik për IEA-të dhe institucionet komunale" me nr. të Prokurimit, 613-25-376-1-2-1,

**Vërtetohet,** *Njoftimi mbi Vendimin e AK-së,* i publikuara në platformen e prokurimit të datës: 21.03.2025.

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.

2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elekronike në adresën : https://e-prokurimi.rks-gov.net.

## A r s y e t i m

**Autoriteti kontraktues Komuna e Lipjanit ka pranuar kërkesë për Rishqyrtim më dt: 26.03.2025, për aktivitetin e prokurimit me titull"** "Furnizim me material hixhenik për IEA-të dhe institucionet komunale" me nr. të Prokurimit, 613-25-376-1-2-1, përmes sisitemit elektronik ne E-prokurim.

Me pretendimet sic vijon:

Pretendimi 1:

Njoftimi për kontratë në këtë aktivitet të prokurimit është bërë me 03.02.2025, ndërsa hapja e ofertave është bërë me dt. 24.02.2025 ku kompania jonë ka qenë ofertuese duke plotesuar te gjitha specifikimet teknike te DT.
Me dt. 13.03.2025 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me vendimin e AK-së,Leter standarde per tenderuesin e pa sukseshem dhe duke rekomanduar per kontrate OE TEKNIKA SHPK

Gjatë vlerësimit të ofertës së OE-së së rekomanduar, kemi konstatuar çmime anormalisht të ulëta. Për pozicionin 25 **Doreza komplet 1/100**

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 25 | Doreza një përdorimëshe | Doreza njëpërdorimshe (materiali: Lateks, masa&ngjyra e bardhë ose tjetër: S, M, L, XL me Puder, prodhuar nga goma e vërtetë natyrale, njësia/paketimi:1 /100) | Copë | 1000 | 0.20 | 200.00 |

ai ka ofruar çmim prej 0.20 €,per pako
Për më tepër, vetë OE-ja ka ofruar çmim prej **3.20 €** për të njëjtin produkt tek pozitcioni 12 -

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 12 | | Dorza per ni perdorim 1x 100 cope (pako) pa puder | pako | 150 | 3.20 | 480.00 |

**Përgjigjeja në pretendimin e parë:**

1. Sa i përket këtij pretendimi ju nëse lexoni saktë paramasën me kujdes nuk është i njejti produkt, për shembull, Doreza tek pozicioni 25 ku ju keni përshkruar është **ME PUDËR**, ndërsa pozicioni me nr 12 është **PA PUDËR**, gjithashtu kanë edhe specifika tjera sic përshkruhet edhe në përshrimin e dy pozicioneve.

Pra nesë e analizoni mire nuk është një produket por janë 2 produkte.

**Ky pretendim është i pa bazuar.**

**Pretendimi nr 2;**

Po ashtu, në **Specifikacionin e furnizimit me material higjienik për QKMF**, Tek Pozitconi 8 OE-ja e rekomanduar për kontratë ka ofruar **Letër për dispenzer, celulozë e pastër, trefletëshe, 700 gr, gjerësi 20 cm, paketim 1 x 6 copë**. Është e qartë se ky pozicion kërkohet për paketë, ndërsa OE-ja ka ofruar çmim për copë **1.30 €**,

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 8 | | Leter per dispanzer celuloze e paster tre shtresore me peshe 700 gr, gjersia 20 cm, 1 x 6 cope(Paketimi) | copë | 1000 | 1.30 | 1,300.00 |

çmimi real për paketën prej 6 copësh është **8.50 € – 9.00 €**. Ky devijim ka ndikuar në mënyrë të padrejtë në vlerësimin e ofertave, duke e bërë ofertën tonë më të lartë per rreth 8200 Euro per ne qe kemi ofuar qmim per pako 1x6 siq kerkohet ne dosjen e tenderit

OE i propozuar ka ofruar një çmim prej **1.3 EUR për një njësi të letrës për aparate (700 g / 6 copë)**, që është dukshëm më i ulët se çmimet mesatare të tregut dhe ato të specifikuara në kërkesat e tenderit.

Autoriteti Kontraktues ka kërkuar **1000 copë të këtyre letrave**, dhe me këtë çmim, vlera totale e ofruar është ekonomikisht e paqëndrueshme dhe e pazbatueshme në praktikë.

Duke qenë se çmimi është ofruar **për një njësi (copë) dhe jo për një paketim**, kjo ofertë bie ndesh me logjikën e tregut dhe nuk mund të realizohet me këtë çmim, pasi furnizimi me këtë kosto është i pamundur për asnjë furnizues.

Për më tepër, duke krahasuar çmimin tonë prej **9.4 EUR për paketimin 6 copë**, oferta e fituesit është **86.2% më e lirë**, një diferencë ekstreme që tregon qartazi se ky çmim nuk është real dhe nuk përmbush kriteret e një furnizimi të qëndrueshëm.

**Përgjigjeja në pretendimin e dytë:**

1. Sa i përket këtij pretendimi ju nëse lexoni saktë paramsën me kujdes të shtuar sic përcaktohet në pozicionin "8 Leter për dispanzer celuloze e paster tre shtresore me peshe 700gr, gjersia 20cm, 1 x6 (paketimit)" është plotësuar paramasa sipas kërkesës së

DT, ndërsa ju jeni hyre ne interpretime që nuk janë relevante, sepse sasia është 1000x1.3=1300€.

**Ky pretendim është i pa bazuar.**

**Pretendimi nr 3:**

> Tek pozicionet 36, 48, 49, 66 dhe 90, OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar çmime që nuk ekzistojnë në treg dhe e ka të pamundur t'i dëshmojë si çmime reale. Për më tepër, mungesa e provave të besueshme e bën të qartë se këto çmime nuk mund të verifikohen lehtësisht, duke ngritur dyshime mbi qëndrueshmërinë dhe realizueshmërinë e ofertës së tije.



| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 36 | Xhoker me mekanizem për Pastrim të dyshemes - vetëm popuqja e xhokerit | Harni i gjokerit duhet të jetë 1 metër zëvendësues i të dëmtuarit | Copë | 150 | 0.20 | 30.00 |
| 48 | Fshesë e thjeshtë dore - e Kashtës | Fshesë e thjeshtë dore - e kashtës (materiali: me fije kashte, ngjyra: natyrale, gjatësia 145 cm | Copë | 250 | 0.29 | 72.50 |
| 49 | Brushë e fortë | Brushë për pastrim, e fortë, materiali dru ose plastike | Copë | 150 | 0.15 | 22.50 |
| 66 | Shporta INOX (10 litershe) | Furnizimi me shporta per tualete, te punuar nga materiali me kualitet te larte INOX , hapje dhe mbyllje me suste, vellim prej 10 litrave, para se te furnizohen me keto lloj shporta duhet te | Copë | 100 | 2.79 | 279.00 |
| 90 | Aparat për aromatizues | Rinovon duke lëshuar sasinë e përsosur të aromës në hapësirë, me sistemin automatik. Aparatin mund ta vendosni kudo.Materiali: Plastik;Kapaciteti: 250 ml | Copë | 25 | 0.80 | 20.00 |

> AK ka shpallur një vendim që është në kundërshtim me kërkesat e specifikuara në dokumentacionin e tenderit, duke miratuar një OE që ka ofruar çmime të papërballueshme dhe abnormale për t'u realizuar, të cilat janë të pamundura për t'u siguruar sipas kushteve të kërkuara. Kjo nuk përputhet me standardet e përcaktuara dhe ngre dyshime mbi validitetin e ofertës. Prandaj, kërkojmë që lënda të kthehet për rivlerësim, për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e tenderit dhe një proces të drejtë dhe të ligjshëm.

**Përgjigjeja në pretendimin e Tretë:**

1. Sa i përket këtij ju vetëm këni përshkruar mendimin e juaj në cilësinë e OE, pasi që edhe ju gjatë përshkrimit keni potencuar në mes të tjerash citoj: "**Për më tepër, mungesa e provave të besueshme e bën të qartë se këto çmime nuk mund të verifikohen lehtësisht, duke ngritur dyshime mbi qëndrueshmërinë dhe realizueshmërinë e ofertës së tije**" pra sic shifet në Kërkesën për Rishqyrtim ju nuk keni argumentuar me

| Nr1 i prokurimit | 613-25-376-1-2-1 |
|---|---|
| Nr i brendshëm | 613 25 003 121 |

gjatë

Ky p

Titulli: Furnizim me material hixhenik për IEA-të dhe institucionet komunale.

**<u>Qendrojme prapa Ofertës sonë financiare, pasi qe ne nje pjese te madhe te tyre e kemi ne depo pra kemi stoqe te shumta, gjithashtu sigurojna AK se nese rekomandohemi per kontrate qe do ju bejem furnizimin sipas kushteve te kontrates, dhe pershkrimit te cmimit sipas paramases.</u>**

at e
LIK
Nr.

tetet

TEKNIKA SH.P.K

SH.P.K TEKNIKA PRISHTINË

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

me

Gjithashtu AK ka ndjekur edhe hapin tjeter duke kërkuar rritjën e **Sigurimit të Ekzekutimit** në raste se OE në fjalë rekomandohet për kontratë dhe hyn në mardhënie kontraktuale AK Komunën e Lipjanit, dhe nuk i përmbahet KPK dhe KVK të kontratës, është si garancion për konfiskim të sigurimit të ekzekutimit, të cilën shkresë do ta keni shtojcë të këtij vendimi.

Për të gjitha këto jeni në njohuri sepse edhe gjatë qasjes keni pranuar dokumentet e tilla.
Krejt në fund Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar për kontratë OE i cili ka qenë më çmimin më të lirë të përgjegjshëm.

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lartë, më dt; 28.03.2025, ka vendosur si ne dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla juridike:
Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Bekim Shabani

Drejtor i Prokurimit

## "TEKNIKA" SHPK

Adresa:Tringe Smaili – Prishtinë

NUI: 810133116

Nr Knt.044 838 869

Nga : Teknika SHPK *Për:* **KUVENDI KOMUNAL LIPJAN**

*Data:* ***18.03.2025***

*Lënda : **DEKLARATE*** **– PERGJIGJJA E LETRES STANDARDE**

Kompania jone Teknika shpk , me seli ne Prishtine, Rr. Tringe Smaili per tenderin me titull ;

| | |
|---|---|
| **Nr1 i prokurimit** | **613-25-376-1-2-1** |
| **Nr i brendshëm** | **613 25 003 121** |

**Titulli: Furnizim me material hixhenik për IEA-të dhe institucionet komunale.**

**Qendrojme prapa Ofertës sonë financiare, pasi qe ne nje pjese te madhe te tyre e kemi ne depo pra kemi stoqe te shumta, gjithashtu sigurojna AK se nese rekomandohemi per kontrate qe do ju bejem furnizimin sipas kushteve te kontrates, dhe pershkrimit te cmimit sipas paramases.**

TEKNIKA SH.P.K

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

# "TEKNIKA" SHPK

Adresa:Tringe Smaili – Prishtinë

NUI: 810133116

Nr Knt.044 838 669

Nga : Teknika SHPK Për: KUVENDI KOMUNAL LIPJAN

*Data:* ***19.03.2025***

*Lënda :* ***DEKLARATE ME SHKRIM*** **– PERGJIGJJA E LETRES STANDARDE TE DATES 18.03.2025**

Kompania jone Teknika shpk , me seli ne Prishtine, Rr. Tringe Smaili per tenderin me titull ;

| | |
|---|---|
| **Nr1 i prokurimit** | **613-25-376-1-2-1** |
| **Nr i brendshëm** | **613 25 003 121** |

**Titulli: Furnizim me material hixhenik për IEA-të dhe institucionet komunale.**

**NE KOMPANIA TEKNIKA SHPK NEPERMJET KESAJ DEKLARATE ME SHKRIM JU KONFIRMOJME DHE PRANOJME VLEREN ME RRITJE PER SIGURIMIN E EKZEKUTIMIT NGA 10% NE 20% TE VLERES SE KONTRATES KONFORM KERKESES SUAJ.**

TEKNIKA SH.P.K

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit